



E martë, 2 dhjetor 2008
ref 007/08

Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (EUSR), Pieter Feith: Procesi i Stabilizim-Asociimit është proces udhëheqës në integrimin evropian të Kosovës si pjesë e rajonit të gjerë

Në hapje të takimit të 15-të plenar të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim-Asociimit të mbajtur sot në Prishtinë, i cili është kryesuar nga Komisioni Evropian në Kosovë, Përfaqësuesi Special i BE-së (EUSR), Pieter Feith ka bërë këtë deklaratë:

Përfaqësuesi Special i BE-së, Pieter Feith:

“Procesi i Stabilizim-Asociimit paraqet një kornizë të marrëdhënieve me ndikim të gjerë mes BE-së dhe Kosovës. Unë pres që në vitet në vijim Kosova të arrijë përparim në fushat, si qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, reformat ekonomiko-fiskale si dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave.”

“Ndonëse ne po kalojmë nëpër kohëra përplot zhvillime politike, autoritetet e Kosovës duhet të vazhdojnë të punojnë në reforma, me qëllim që të rritet përparimi në rrugën evropiane të Kosovës si pjesë e rajonit. Sa i përket BE-së, ne do të vazhdojmë t’jua ofrojmë mbështetjen tonë të plotë.”

Vërejtje për redaktorë:

Për më shumë informata rreth takimit të 15-të plenar të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim-Asociimit, ju lutem vizitoni ueb-faqen e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë:
<http://www.delprn.ec.europa.eu/>